

LIGJ
Nr.7553, datë 30.1.1992

PËR DISA NDRYSHIME NË KODIN PENAL TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Pas nenit 60 shtohet neni 60-a me këtë përmbajtje:

Korrupsioni politik

Marrja ose pranimi për të marrë, për vete ose për të tjerët, shpërblim në të holla ose sende të tjera për të kryer veprime në kundërshtim me interesat kombëtare, dënohet:
me heqje të lirisë jo më pak se 10 vjet ose me vdekje.

Neni 2

Në nenin 71 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

Dëmtimi ose bllokimi i ujësjellësave, linjave të tensionit të lartë e atyre telefonike, dënohet:
me heqje të lirisë gjer në pesë vjet.

Neni 3

Pas nenit 73 shtohet neni 73-a me këtë përmbajtje:

Përgatitja dhe shitja e prodhimeve ushqimore të rrezikshme për shëndetin

Përgatitja, importimi, ruajtja dhe shitja e prodhimeve ushqimore, e pijeve dhe barnave të rrezikshme ose të dëmshme për jetën ose shëndetin, si dhe futja në përdorim e kimikateve, materialeve dhe lëndëve shtesë në prodhimin e përpunimin e artikujve ushqimorë e të pijeve, kur nga këto vepra kanë ardhur pasoja të rënda dënohen:
me heqje të lirisë nga dy gjer në njëzet vjet.

Neni 4

Pas nenit 78 shtohet neni 78-a me këtë përmbajtje:

Pengimi i qarkullimit të mjeteve të transportit

Vënia e pagesave dhe ndalimi me çdo mjet e mënyrë i qarkullimit të mjeteve të transportit automobilistik, hekurudhor, detar e ajror, dënohet:
me heqje të lirisë gjer në tre vjet.

Neni 5

Pas nenit 94 shtohet neni 94- me këtë përmbajtje:

Rrëmbimi i personit

Rrëmbimi i personit me qëllim për të fituar pasuri ose për të siguruar përfitime të tjera, dënohet:

me heqje të lirisë jo më pak se dhjetë vjet;

Rrëmbimi, fshehja ose zëvendësimi i fëmijës së tjetrit dënohet:

me heqje të lirisë jo më pak se dhjetë vjet ose me vdekje.

Neni 6

Paragrafi i dytë i nenit 101 ndryshohet si vijon:

Vjedhja e pasurisë së tjetrit e kryer më shumë se një herë ose nga një grup i organizuar ose në përpjestime të mëdha dënohet:
me heqje të lirisë jo më pak se tre vjet ose me vdekje.

Neni 7

Në nenin 105 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

Shkatërrimi ose dëmtimi i pasurisë së tjetrit i kryer me zjarr ose me mjet tjetër të rrezikut të përbashkët, dënohet:
me heqje të lirisë jo më pak se pesë vjet.

Neni 8

Pas nenit 105 shtohet neni 105-a me këtë përmbajtje:

Vjedhja ose shpërdorimi i ndihmave humanitare

Vjedhja ose shpërdorimi i ndihmave humanitare që hyjnë në Republikën e Shqipërisë dënohet:
me heqje të lirisë nga gjashtë muaj gjer në dhjetë vjet.

Po kjo vepër e kryer nga një grup i organizuar ose në përpjestime të mëdha dënohet me heqje të lirisë nga pesë gjer në njëzet vjet.

Neni 9

Në nenin 118 hiqen fjalët "e të Partisë".

Neni 10

Neni 118-a ndryshohet si vijon:

Kundërshtimi ndaj përfaqësuesit të shtetit

Kundërshtimi me dhunë fizike ose në bashkëpunim që i bëhet përfaqësuesit të shtetit, kur është duke kryer detyrën sipas ligjit, dënohet:
me heqje të lirisë gjer në dhjetë vjet.

Neni 11

Pas nenit 120 shtohet neni 120-a me këtë përmbajtje:

Pengimi me dhunë i veprimtarisë së partive politike

Pengimi me dhunë i veprimtarisë së ligjshme të partive, organizatave dhe shoqatave politike, dënohet:
me heqje të lirisë gjer në pesë vjet.

Neni 12

Në nenin 129 hiqen fjalët "me riedukim nëpërmjet punës".

Neni 13

Paragrafi i dytë i nenit 134 ndryshohet si vijon:

Përgatitja, importimi, mbajtja dhe shitja e drogës dhe lëndëve të tjera narkotike pa leje, dënohet:
me heqje të lirisë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Neni 14

Pas nenit 137 shtohet neni 137-a me këtë përmbajtje:

Dhunimi i varreve

Gërmimi ose prishja e varreve, nxjerrja e kufomës, si dhe përvetësimi i sendeve që mund të ndodhen në varr, dënohet:

me heqje të lirisë gjer në dhjetë vjet.

Neni 15

Neni 10 ndryshohet si vijon:

Pushtimi dhe shpërdorimi i tokës

Pushtimi dhe shpërdorimi i tokës, si dhe pengimi me dhunë për zbatimin e ligjit për tokën, dënohet:

me heqje të lirisë nga gjashtë muaj gjer në dy vjet.

Neni 16

Neni 173 ndryshohet si vijon:

Prerja e paligjshme e pyjeve ose dëmtimi i tyre

Prerja e paligjshme e pyjeve ose dëmtimi i tyre, si dhe prerja e pemëve, drurëve jofrutorë ose dekorativë, kur vepra nuk formon kundërvajtje administrative, dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në një vit.

Neni 17

Pas nenit 216 shtohet neni 216-a me këtë përmbajtje:

Pengimi ose ndalimi i ushtrimit të shërbimeve fetare

Pengimi ose ndalimi i ushtrimit të shërbimeve fetare, dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në dy vjet.

Neni 18

Neni 224 ndryshohet si vijon:

Prodhimi, mbajtja, blerja ose shitja e armëve

Prodhimi, importimi, transportimi, mbajtja, blerja ose shitja e armëve të zjarrit dhe e lëndëve plasëse pa lejen e organeve kompetente dënohet:

me heqje të lirisë nga një gjer në dhjetë vjet.

Prodhimi, importimi, mbajtja, blerja ose shitja e armëve të ftohta pa lejen e organeve kompetente dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në dy vjet.

Neni 19

Neni 234 ndryshohet si vijon:

Përgatitja dhe shitja e prodhimeve ushqimore të rrezikshme për shëndetin

Përgatitja, importimi, ruajtja dhe shitja e prodhimeve ushqimore, e pijeve dhe barnave të rrezikshme ose të dëmshme për shëndetin, si dhe futja në përdorim e kimikateve, materialeve dhe lëndëve shtesë në prodhimin e përpunimin e artikujve ushqimorë e të pijeve, dënohet:

me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në dy vjet.

Neni 20

Fjalët "pasuri socialiste" që përmenden në këtë Kod, të zëvendësohen me fjalët "pasuri shtetërore e shoqërore".

Neni 21

Shfuqizohen: paragrafi i dytë i nenit 32 dhe nenet 53, 55, 60, 64, 164, 165, 178 e 205.

Neni 22

Ky ligj hyn në fuqi më datën 10 shkurt 1992.

Shpallur me dekretin nr.120, datë 4.2.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ramiz Alia.